



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 47 paragrafi 1 pika 6 të Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 158/10, 123/12 dhe 43/14) dhe neni 35 paragrafi 1 të Ligjit për punë valutore („Gazeta zyrtare e RM”, nr. 34/01, 49/01, 103/01, 51/03, 81/08, 24/11, 135/11 dhe 188/13), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë mori këtë

VENDIM

për ndryshimin e Vendimit për mënyrën e formimit dhe publikimit të kurseve të këmbimit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë

1. Në Vendimin për mënyrën e formimit dhe publikimit të kurseve të këmbimit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë („Gazeta zyrtare e RM”, nr. 58/14 dhe 102/14) shtojca 1, nga pika 2 zëvendësohet me shtojcë të re 1, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Në pikën 5, paragrafi 2 ndryshohet si më poshtë:

“Në përjashtim të paragrafit 1 të kësaj pike, Banka Popullore e zbaton kursin mesatar për valuta të huaja, të Listës së kursit të këmbimit:

 - për transaksione të shitblerjes me autoritete shtetërore të cilat kryhen në të njëjtën ditë dhe kur për pagesat e autoriteteve shtetërore jashtë vendit shfrytëzohen mjetet nga llogaria valutore e autoriteteve shtetërore në Bankën Popullore në valutën e njëjtë si dhe valutën e pagesave,
 - në raste kur kryhen transfere nga dhe drejt llogarive valutore për kredi revolving të autoriteteve shtetërore që mbahen në Bankën Popullore dhe
 - për transaksione të shitblerjes me autoritetet shtetërore për pagesa jashtë vendit të cilat janë të rregulluara me kontrata të lidhura me Bankën Popullore”.
3. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e publikimit në „Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

V. nr. 02-15/I-3/2015
29 janar 2015
Shkup

Guvernator
dhe Kryetar i
Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë
Dimitar Bogov

Shtesa 1

Lista e kursit të këmbimit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë e formuar me datë _____ dhe e cila aplikohet nga 00:00 me datë _____ deri në hyrje në fuqi të Listës së re të kursit të këmbimit

		Shteti	Shifra	Valuta		Njësi valutore	Kursi mesatar në denarë
1.		UEM	978	Euro	EUR	1	
2.		SHBA	840	Dollari Amerikan	USD	1	
3.		Britania e Madhe	826	Paundi Britanik	GBP	1	
4.		Zvicra	756	Franga Zviceriane	CHF	1	
5.		Suedia	752	Korona Suedeze	SEK	1	
6.		Norvegjia	578	Korona Norvegjeze	NOK	1	
7.		Japonia	392	Jeni Japonez	JPY	1	
8.		Danimarka	208	Korona Daneze	DKK	1	
9.		Kanada	124	Dollari Kanadez	CAD	1	
10.		Australia	036	Dollari Australian	AUD	1	
11.		Bullgaria	975	Leva Bullgare	BGN	1	
12.		Republika Çeke	203	Korona Çeke	CZK	1	
13.		Hungaria	348	Forinta Hungareze	HUF	1	
14.		Polonia	985	Zloty Polonez	PLN	1	
15.		Romania	642	Lei i Ri Rumun	RON	1	
16.		Kroacia	191	Kuna Kroate	HRK	1	
17.		Turqia	949	Lira Turke	TRY	1	
18.		Rusia	643	Rubla Ruse	RUB	1	
19.		Brazili	076	Real Brazilian	BRL	1	
20.		Kina	156	Juani Kinez	CNY	1	
21.		Hong Kong	344	Dollari i Hong Kongut	HKD	1	
22.		Indonezia	360	Rupia Indoneziane	IDR	1	
23.		Izraeli	376	Shekeli Izraelit	ILS	1	
24.		India	356	Rupia Indiane	INR	1	
25.		Korea Jugore	408	Voni Koreanojugor	KRW	1	
26.		Meksika	484	Peso Meksikane	MXN	1	
27.		Malajzia	458	Ringiti Malajzian	MYR	1	

28.		Zelanda e Re	554	Dollari i Zelandës së Re	NZD	1	
29.		Filipinet	608	Peso Filipineze	PHP	1	
30.		Singapuri	702	Dollari i Singapurit	SGD	1	
31.		Tailanda	764	Bahti Tailandez	THB	1	
32.		Afrika Jugore	710	Randi Afrikanojugor	ZAR	1	